



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

Bernë, 26 nëntor 2009

MUNDËSI PËR INVESTIME NË KOSOVË
Situata e Përgjithshme Ekonomike në Kosovë dhe Përkushtimi Qeveritar për të
Tërhequr Investime Direkte të Jashtme

I nderuari Ambasador Malaj,
Zonja dhe zotërinj

Është kënaqësi e madhe të jesh sot në Bernë për këtë konferencë të rëndësishme për mundësitë e investimeve në Kosovë. Më lejoni që si Ministër i Tregtisë dhe Industrisë të hap skenën dhe prezantoj Kosovën si partnerin më të ri të biznesit të Evropës. Jam i entuziazmuar që kam mundësinë për të ju dhënë një pamje të përgjithshme të situatës ekonomike në vendin tim si dhe arritjet dhe sfidat e qeverisë për të promovuar investimet.

Para se të filloj, do të kisha dashur të falënderoj Qeverinë zvicerane dhe qytetarët e saj për përkrahjen e vazhdueshme në sferën politike dhe atë ekonomike dhe nuk duhet të lë pa përmendur që Kosovarët kanë qenë gjithmonë të përkushtuar dhe të etur që çdoherë të kenë marrëdhënie reciproke të dobishme me Zvicrën. Ndihem i privilegjuar të jem pjesë e kësaj konference duke parë se interesi i pjesëmarrësve tregon qartë dëshirën e tyre për të njohur nga afër Kosovën dhe për të marrë pjesë në zhvillimin e saj.

Kosova vërtetë është vendi më i ri dhe më i vendosur e cili, që nga shpallja e pavarësisë në shkurt të vitit 2008, ka filluar një program zhvillimor madhor social dhe ekonomik i cili do të shërbej si bazë për një të ardhme të suksesshme. Kosova është shumë e vetëdijshme që pavarësia sjell me vete mundësitë për rritje dhe zhvillim në të gjitha sferat bashkë me përkushtimin për të ndërtuar një vend të lirë dhe demokratik ku të gjithë qytetarët do të kenë mundësi të barabarta dhe të gjithë vizitorët do të trajtohen me respektin dhe konsideratën më të lartë.

Ndonëse edhe Kosova ka qenë e prekur nga kriza ekonomike botërore, rritja e Bruto Prodhimit Vendor (BPV) pritet të jetë mbi 4% dhe investimet publike janë rritur për rreth 200%. Megjithatë, BPV-ja e Kosovës për kokë banori mbetet në 1,700 Euro; papunësia mbetet në nivelin 40% duke dëmtuar më shumë të rinjtë. Sektori privat duhet të forcohet së bashku me mekanizmat për konkurrencë me të madhe. Gjithashtu



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

edhe nevoja për inkurajimin e krijimit të NVM-ve. Sidoqoftë, pranimi i Kosovës në FMN dhe Bankën Botërore në fillim të këtij viti është mbështetje e madhe për zhvillimin ekonomik të saj.

Një mundësi për zhvillim ekonomik është përmirësimi i klimës ekonomike për rritje të investimeve direkte, e cila është një ndër strategjitë kryesore për të përmirësuar ekonominë e Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës ka dhënë kontribut të theksueshëm për të siguruar prirje pozitive për investitorët në fushat siç janë: sigurimi, çështjet politike, ekonomia, legjislacioni etj. Ne kemi punuar drejt plotësimit të të gjitha standardeve ndërkombëtare përmes pjesëmarrjes së Kosovës në Programin për Partneritet Evropian, dhe qeveria jonë është e përkushtuar për të përmbushur të gjitha kushtet sa më parë që të jetë e mundur si dhe të plotësoj kriteret përkatëse për integrim në Bashkësinë Evropiane. Qëllimi ynë kryesorë mbetet rritja e konkurrencës ekonomike në rajon dhe më gjerë. Ne jemi duke bërë hapat e parë vendimtarë për të tërhequr investimet e huaja në vendin tonë. Ne besojmë që tani më shumë se kurrë më parë Kosova ka nevojë për investime të huaja për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve të saj dhe të kontribuoj në zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik dhe të bëhet pjesë e familjes së madhe Evropiane në të cilën jemi duke provuar të hyjmë së bashku me vendet tjera të Evropës Juglindore.

Zonja dhe zotërinj,

- Kosova ka vend qendror në rajon, me kryeqytetin e saj, Prishtinën, distanca e të cilit nga cilido vend fqinjë është vetëm disa orë vozitje larg. Infrastruktura në vazhdimësi po zhvillohet për të lejuar vozitje me të shpejtë dhe më të rehatshme brenda dhe jashtë Kosovës.
- Me mbi 70% të popullatës nën moshën 35 vjeçare, Kosova ka popullatën më të re në regjion, e cila gjithashtu është e edukuar, shumëgjuhëshe dhe dinamike. Kjo krijon një treg elastik të punës dhe forcë konkurrenente punëtore të shkathtë.
- Në Kosovë ekziston telekomunikacioni modern me disa operatorë mobil dhe fiks të cilët ofrojnë teknologjinë e kohës së fundit me çmime më të ulëta nga cilido tjetër vend në Evropë.
- Gjithashtu, gjatë dhjetë viteve të kaluara, legjislacioni i Kosovës është rindërtuar dhe tani është plotësisht në pajtim me legjislacionin e BE-së. Legjislacioni i Kosovës për investitorëve të huaj ofron "trajtim kombëtarë".



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY**

**KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER**

- Është e rëndësishme të theksohet që politikat fiskale kanë ndryshuar dhe tani niveli i tatimit të përbashkët dhe tatimit në të hyra personale është ndër më të ulët në Evropë.
- Për më tepër, Kosova posedon sistem bankar të shëndosh me Euron si valutë zyrtare e saj. Me këtë do të kisha dashur të theksoj që në një kohë të krizës ekonomike globale, bankat të cilat funksionojnë në Kosovë nuk janë prekur ende; në të vërtetë, ato kanë shënuar një rritje e vazhdueshme të depozitave e cila na tregon që ky regjion sjell siguri për investime në një kohë të krizës.

Unë nuk do të ndalem për të diskutuar klimën e investimeve pasi që folësi i radhës do të ju ofroj të gjitha detajet dhe mundësitë. Megjithatë, më lejoni që shkurtimisht dhe me krenari të përmend disa sektorë të biznesit që posedon Kosova në mënyrë që të sqaroj burimet e saj. Së pari, Kosova ka një pasuri të lakmueshme të burimeve natyrore, dhe në fakt ajo përpunon rezerva të vërtetuara të linjtit që vlerësohen të zënë vendin e pestë për rezerva më të mëdha në botë. Kosova gjithashtu është e pasur me tokë bujqësore, mbi gjysma e kësaj toke është e punueshme. Gjithashtu ekziston edhe potencial i madh i tregut për përpunim të ushqimit, i cili u ofron investitorëve potencial qasje tek furnizuesit ose në material të papërpunuar, kapital substancial i trashëguar, aftësi teknike, dhe prodhime premtuese për tregun. Sektorë tjerë janë bagëtia dhe shpendaria, vreshtaria, industria e komponentëve automobilistike, tekstili, ndërtimtaria, teknologjia informative dhe telekomunikacioni, dhe përpunimi i drurit. Sektori i turizmit, posaçërisht ai i sezonit dimërorë ka potencial të lartë të investimeve.

Siç e dimë, shumë kompani Zvicerane kanë ndjekur klimën pozitive të biznesit në Kosovë dhe kanë ndërmarrë një numër të operacioneve të suksesshme në shumë sektorë brenda Kosovës. Tashmë rreth 90 kompani Zvicerane janë duke operuar në Kosovë në industrinë siç janë: prodhimi, ndërtimtaria, transportimi, tregtia, dhe shërbime të cilat kanë krijuar shumë mundësi për punësim në Kosovë. Siç mund të shihni, bashkëpunimi ekonomik mes dy vendeve tona është duke u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të favorshme, dhe ne aspirojmë të kemi një interesim të shtuar për investime të mëtutjeshme në Kosovë nga Komuniteti i Biznesit të Zvicrës.

Gjithashtu do të kisha dashur të përmend faktin se edhe pse Kosova ka shënuar një mungesë të ekuilibrit tregtarë, tregtia në mes të Kosovës dhe Zvicrës ka shënuar rritje. Me këtë rast, do të doja të theksoj për investitorët potencial Zviceranë që të shohin mundësinë që ka Kosova me qasjen e saj të lirë në tregjet e BE-së dhe anëtarët e CEFTA-



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

s, e cila sjell përfitime të mëdha, veçanërisht nga qasja jo-reciproke dhe pa doganë në tregun e BE-së e bazuar në Regjimin Autonom të Preferencës Tregtare (ATP) të BE-së. Nëpërmes funksionimit të CEFTA-s, investitorëve nga Zvicra u jepet mundësia të tregtojnë gati të gjitha produktet e tyre të prodhuara në Kosovë pa ndonjë barrierë tarifore ose jo-tarifore në një treg të përbashkët me më shumë se 28 milion konsumatorë. Kosova gjithashtu ka një marrëveshje të ngjashme me Shtetet e Bashkuara, e cila krijon një treg shumë më të madh për produkte të caktuara të prodhuara në Kosovë.

Zonja dhe zotërinj,

Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë reforma të vullshme të klimës së përgjithshme të biznesit për të lehtësuar investimet e huaja. Për të përmirësuar ambientin e biznesit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes agjencive dhe departamenteve të saja ofron infrastrukturën fizike dhe legale për bizneset aktive dhe ato që fillojnë aktivitetet e tyre. Agjencia për Mbështetje të NMV-ve, p.sh. ofron parqe të biznesit në Drenas, Mitrovicë si dhe inkubatorë në Shtime, Deçan, dhe Gjilan. Ajo gjithashtu ofron shërbime këshilluese dhe trajnuese siç është Skema Garantuese (ang. Vaucher Scheme) për biznese. Ne kemi Agjencitë për Standardizim dhe Akreditim të cilat sigurojnë që produktet e prodhuara në vend do të prodhohen sipas standardeve ndërkombëtare dhe do të jenë konkurruese jo vetëm në tregun vendor por edhe në atë ndërkombëtarë. Agjencia për Regjistrim të Biznesit ka bërë përmirësimin e tërësishëm të sistemit për të përmirësuar dhe bërë më të efektshëm procesin e regjistrimit të biznesit tuaj i cili aktualisht është më i thjeshti dhe më i shpejti në regjion.

Agjencia më e rëndësishme e investitorëve, e cila duhet të jetë pika e parë e ndaljes që ata duhet ta bëjnë në orvatjet e tyre për investime në Kosovë, është Agjencia për Promovimin e Investimeve që vepron nën Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe unë i nxis investitorët aktual dhe të ardhshëm që ta shfrytëzojnë atë. APIK ka edhe një zyrë në Vjenë, e cila tani, në bashkëpunim të ngushtë me APIK, është duke i shtuar aktivitetet e ndërtimit të imazhit dhe aktivitetet tjera drejt identifikimit të investitorëve potencial në regjionin Gjermano-folës duke ju ofruar atyre informacione dhe shërbime falas lidhur me mundësitë për investime në Kosovë. Të dy këto zyra të APIK-ut operojnë me personel profesional dhe shumëgjuhësh, i cili është gjithmonë i gatshëm të ndihmoj dhe udhëzoj investitorët gjatë orvatjeve të tyre në vendin më të ri të Evropës. Programi i APIK-ut për pas-përkujdesje ndaj investitorit gjithashtu siguron që



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

operacionet tuaja afariste në Kosovë të zbatohen me sukses. Për të siguruar arritjen e objektivave dhe trajtim të barabartë dhe të drejtë të investitorëve të huaj kohëve të fundit është krijuar Bordi i FDI-së, me të cilin udhëheq unë.

Zonja dhe zotërinj,

Dëshiroj të përfundoj këtë fjalim duke përmendur faktin që qeveria jonë sapo ka krijuar imazhin e saj identifikues, i cili është "Kosova, Evropianët e rinj." Ne dëshirojmë që bota të shoh se Kosova vërtetë është një vend përplot me individ të rinj, të motivuar dhe dinamik të cilët përshatën me lehtësi dhe janë të gatshëm për të mësuar dhe zhvilluar përmes punës së mundimshme në mënyrë që të shkojnë përpara, mu si vendi nga i cili ata vijnë.

Më lejoni të shpreh besimin tim që marrëdhënia në mes të Zvicrës dhe Kosovës do të vazhdoj të përmirësohet me mbështetje të vazhdueshme nga të dyja vendet. Ju falënderoj për kontributin tuaj për zhvillimin e Kosovës përmes investimeve tuaja dhe ndërmarrjeve konkrete dhe ju dëshiroj shumë fat dhe prosperitet.

Faleminderit për vëmendje!